

Më  
Dana

*01-06-2018* NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, në përbërje nga gjyqtari individual Mustaf Tahiri me procesmbajtësen Albënora Bekteshi, në çështjen penale kundër të pandehurit [REDACTED] nga Komuna Ferizaj, i akuzuar për shkak të veprës penale vjedhje pylli nga neni 358 paragrafi 1 të KPRK-së, sipas propozim akuzës – kërkesës për dhënien e urdhrit ndëshkimor të Prokurorisë Themelore në Ferizaj, të evidentuar si: PP.nr.2103-4/17, të datë 11 dhjetor 2017, më 22 shkurt 2018 mori këtë:

#### A K T G J Y K I M

**PRANOHET** kërkesa e Prokurorisë Themelore në Ferizaj me kërkesë për shqiptimin e urdhrit ndëshkimor, të evidentuar si: PP.nr.2103-4/17 të datë 11 dhjetor 2017, dhe gjykata jep këtë:

#### URDHËR NDËSHKIMOR

I pandehuri [REDACTED], nga fshati [REDACTED] – Komuna e Ferizajt, i lindur më [REDACTED] në të njëjtin vend, nga i ati [REDACTED] shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i gjendjes së mesme ekonomike;

#### ËSHTË FAJTOR

Sepse më datë 18 shtator 2017, rreth orës 15:00, në pyllin shoqëror të cilin e menaxhon Drejtoria për Bujqësi dhe pylltari në Ferizaj, në rajonin ekonomiko pyjor Neredime – Jezercë në vendin e quajtur “Plenija”, me qëllim vjedhje ka prerë 1 dru të llojit ahut me diametër 49.60cm, boniteti III,

gjithsej në kubaturë prej 3.00 m<sup>3</sup>, vlera e dëmit të shkaktuar është 405.00 €, të cilët drunj i ka bartur me traktor rakkovica.,

- **me të cilin veprim ka kryer veprën penale vjedhje pylli nga neni 358 paragrafi 1 të KPRK-së.**

Andaj gjykata në bazë të dispozitës së lartë shënuar dhe bazuar në dispozitën e nenit 4,7,17,21,41,42,43, 46 dhe 73 të KPRK-së dhe nenit 378 paragrafi 6 lidhur me paragafin 1 të KPRK-së të pandehurin:

### **GJYKON**

**DËNIM ME GJOBË** në shumë prej dyqind (200) euro, të cilin dënim është i obliguar që ta paguaj në afat prej tridhjetë (30) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në rast se dënimini me gjobë nuk mund të ekzekutohet as me detyrim sipas nenit 46 paragrafi 3 të KPRK-së, i njëjti do i shndërrohet në dënim burgimi, ashtu për çdo njëzet (20) € do t'i llogaritet një (1) ditë burgimi.

Obligohet i pandehuri që të dëmtuarës Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë në Ferizaj, t'ia paguajë shumën në vlerë prej katërqind e pesë (405.00) €, në emër të dëmit të shkaktuar, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

Në emër të paushallit gjyqësor i pandehuri obligohet të paguaj shumën në vlerë prej njëzet (20) €, si dhe shumën prej tridhjetë (30) për programin për kompensimin e viktimate të krimtit në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kanosjen e përmbarimit të detyruar.

## A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Ferizaj, me propozim akuzën PP.nr.2103-4/17 të datë 11 dhjetor 2017, ka akuzuar të pandehurin [REDACTED], për shkak të veprës penale vjedhje pylli nga neni 358 paragrafi 1 të KPRK-së, si dhe ka ushtruar kërkesë për dhënien e urdhrit ndëshkimor, me arsyetim se ka prova të besueshme nga kallëzimi penal që vërtetojnë kryerjen e kësaj vepre penale nga i pandehuri.

Gjykata me rastin e shqyrtimit paraprak të propozim akuzës dhe kërkesës për dhënien e urdhrit ndëshkimor gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore për dhënien e urdhrit ndëshkimor në kuptim të nenit 495 paragrafi 1 të KPPRK-së.

Me rastin e vlerësimit të provave materiale të bashkangjitura si në shkresat e lëndës si: fletëparaqitjen e rojës së pyjeve të datë 2 tetor 2017 me nr.672/17, kallëzimin penal me nr.672/17 të datë 3 tetor 2017 të Drejtorisë për Bujqësi dhe Pylltari të Komunës së Ferizajt dhe procesverbalit që gjendet në shkresat e lëndët, konstatoj se këto prova janë bindëse dhe të bazuara dhe njëkohësisht vërtetojnë se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, andaj gjykata të njëjtin e shpalli fajtor dhe i shqiptoj dënimin me gjobë.

Gjykata vlerëson se këto prova janë bindëse dhe të bazuara, të cilat vërtetojnë se në veprimet e të pandehurit ekzistojnë të gjitha elementet e veprës penale për të cilën akuzohet me aktakuzën e Prokurorit të Shtetit.

Obligohet i pandehuri që të dëmtuarës Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë në Ferizaj, t'ia paguajë shumën në vlerë prej katërqind e pesë (405.00) €, në emër të dëmit të shkaktuar, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

Në bazë të nenit 450 të KPP-së, gjykata të akuzuari e obligoi që të paguaj paushallin gjyqësor në shumë prej 20 €, si dhe konform nenit 39 par. 3 pika 3.1 të ligjit nr. 05/L-036 për Kompensimin e Viktimate të Krimit taksën në shumën prej 30 (tridhjetë) euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcenim të përmbarimit me dhunë.

**GJYKATA THEMELORE FERIZAJ**

**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM - DIVIZIONI PENAL**

P.nr. 3113/17

Datë: 22 shkurt 2018

**Procesmbajtësja,**

Albënora Bekteshi

**Gjyqtari,**

Mustaf Tahiri



**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtim, kësaj gjykate, në afat prej tetë (8) ditëve, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi.